

TOLLOVI NË QENDRËN E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE NË LIPJAN

# Gjysma e veturave të paregjistruara u takojnë zyrtarëve të institucioneve

Arian Duriqi

LIPJAN, 24 MARS – Në një hulumtim që e ka kryer së fundi Organizata Joqeveritare YAHR në Lipjan del se mbi 50 për qind e strukturës së personave fizikë që nuk i kanë regjistruar automjetet dhe që tani po i regjistrojnë janë kryesisht zyrtarë të institucioneve të ndryshme, duke filluar nga pjesëtarët e policisë, punëtorët në Administratën publike e deri tek politikanët dhe militantët e partive politike. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka deklaruar se kjo situatë është për çdo kritikë, sepse nuk jepte shembull të mirë të qytetarët. “Në qoftë se qytetari ishte në dijeni se polici, zyrtari komunal apo politikanë nuk e kishte të regjistruar veturën atëherë jepej shembull i keq. Sepse, hulumtimet tona tregojnë se mbi 50 për qind të personave fizikë që po i regjistrojnë veturat e që nuk ishin regjistruar janë zyrtarë komunalë, policë dhe politikanë”, ka thënë Krasniqi. Dhe, vrapin për të regjistruar automjetet pas vendosjes së taksës për regjistrim me vonesë të veturës ka bërë që të krijohen tollovi të mëdha para QRA-së në Lipjan, ndërsa mendohet se Ministria e Punëve të Brendshme ka dështuar në menaxhimin e situatës në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në këtë komunë. “YAHR shpreh shqetësimin e qytetarëve të komunës së Lipjanit lidhur me pritjet e gjata që po ndodhin para QRA-së në Lipjan. MPB-ja ka dështuar në menaxhimin e situatës në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Komunën e Lipjanit, e cila për fat të keq të qytetarëve kjo qendër është hapur disa ditë para zbatimit të taksës për regjistrim me vonesë të automjeteve”, ka thënë Krasniqi. Ndryshe nga kjo, krerë të stacionit policor në Lipjan dhe autoritetet komunale të kësaj komune nuk e besojnë dhe e mohojnë se kanë qenë në dijeni se gjysma e automjeteve të paregjistruara u takonin policëve e



**Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka bërë të ditur se nga hulumtimi i kësaj organizate del se mbi 50 për qind të personave fizikë që po i regjistrojnë veturat e që nuk ishin regjistruar janë zyrtarë komunalë, policë dhe politikanë**

komunarëve. Imer Kaqara, komandant në Stacionin policor në Lipjan, ka deklaruar se ai nuk ka poseduar me informacione të tilla, derisa ka shtuar se disa herë nga zyrtarët e QRA-së është kërkuar asistencë e policisë për mbajtje të rendit. “Sa i përket pyetjes suaj se a ka policë që kanë vozitur pa regjistrim veture, nuk kam njohuri se ka pasur ose ka. Dhe, nuk mendoj se 50 për qind e personave fizikë që nuk i kanë pasur të regjistruara veturat ishin policë të Lipjanit. Ndryshe, çdo pjesëtar i policisë e di mirë se ngasja e veturës pa regjistrim e sigurim është kundërvajtje dhe në bazë të kësaj mund të iniciohet edhe procedurë e brendshme hetimore për mosrespektim ligji në trafik”, ka thënë Kaqara. Ndërkohë që, mohime vijnë edhe nga organet komunale. Hasan Luma, shef i ZIP-it në Lipjan, e pranon se nuk posedon me shifra dhe evidencë të saktë, mirëpo nuk e beson se numër i madh i zyrtarëve veturat i kanë ngarë pa regjistrim. “Mund të përjashtojmë ndonjë rast që ka mundur ta ketë veturën pa sigurim,

mirëpo për qindja që përmendet është pak e lartë dhe nuk besojmë se ka pasur në numër kaq të madh veturash jashtë rregullave në komunikacion nga zyrtarët komunalë”, ka thënë Luma. Për më tepër, rrumbullak 2 vjet e 8 muaj pasi që është përruar ka nisur punën Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Lipjan, ndërsa tash e tutje qytetarët e kësaj komune shërbimet në regjistrim automjetesh po i kryejnë në Lipjan dhe jo në Prishtinë, sikur që ishte bërë deri tashti. Përrurimi i objektit të QRA-së, ndërkaq, ishte bërë saktësisht më 21 korrik të vitit 2010 dhe pati kushtuar rreth 260 mijë euro, derisa ishte ndërtuar me mjete të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në përrurim atëkohë, ministri Bajram Rexhepi premtoi se me këtë rast Lipjani ishte shkëputur nga Prishtina në shërbime civile dhe regjistrim automjetesh. Shërbimet civile, ndërkaq, patën nisur menjëherë, por për 32 muaj rresht ka çaluar regjistrimi i veturave në Lipjan, derisa tashmë bashkë me funksionimin e QRA-së po krijohen edhe tollovi të mëdha.

LDK-j

GJAKOVË, 24 MAR  
akademi katër vej  
Rexhën e Gjergj S  
Isa Mustafa, kry  
rënia e njerëzve s  
tarëve të tjerë, është  
tyre, për LDK-në  
“Mirëpo vepra  
ardhmes sonë, p  
Mustafa në këtë al  
tij, te vepra e këtyr  
dhe vetëflijimit p  
e harmoninë univ  
alitetet të tilla mar  
epoka e rezistenc  
demokraci. Porse  
heronj dhe vetëdij  
tyre një kauze të r  
Duke u ndërlidh  
kryetari i Degës s  
alitetet e ka bashku  
për liri deri në dit  
në Gjakovë mbet  
tribut të pamohue  
pasi më parë ka t  
LDK-së. (G.D.)

Kaçaniku i

KAÇANIK, 24 MAR  
(DBPZHR) e KK i  
vencione dhe tra  
mbështetjen e bu  
cionimin e fermer  
për mbëltim fida  
DBPZHR-së. Sipas  
mineral do të bëhe  
për projekte që do  
thënë Provoliu. R  
fereve nuk ishin c  
euro do të financol  
euro janë dedikua  
ka thënë Provoliu.  
subvencionimin e  
Komunës ndarja e  
për subvencionimi  
radhës të legjislati  
Hajrush Dullovi, z

Banor

SHKOLLA E DRELAJVE TË RUGOVËS MBAN MËSIMIN NË PARALELE TË KOMBINUARA

Drejtoria e Arsim...

GJILAN, 24 MARS  
publik për fshatin,  
i konsiderueshëm  
Driton Ahmeti, t